



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 192 / Prot. 13

Tiranë, më 19.7. 2021

URDHËR

Nr. 235, Datë 19.7.2021

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“DIZAJN” ME PROFILE “DIZAJN GRAFIK” DHE “DIZAJN INTERIER”, NË
UNIVERSITETIN NEW YORK TIRANA**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier” me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”, në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës, në Universitetin New York Tirana, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Dizajn” me profile “Dizajn Grafik” dhe “Dizajn Interier”, në Universitetin New York Tirana, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Universiteti New York Tirana të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti New York Tirana të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti New York Tirana.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

